

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E HËNË 3 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

I kam përcjellë me shqetësim shumë të madh ngjarjet e ditëve të fundit, të cilat lidhen me situatën e arsimit në Shqipëri. Si ishmësuese, si nënë, si grua, si deputete, mendoj se vendimi për mbylljen e shkollës “Mehmet Akif” është i pavend. Më duket një mendim absurd, i ligjëruar vetëm në mendjen e Edi Ramës, që tregon se kjo qeveri është në ditët e saj më të zeza, sa tentakulat e çmendurisë së saj i ka shtrirë edhe në arsim, kulturë dhe dije. Vendimi i Këshillit të Ministrave ka një mungesë të theksuar transparence. Ai qartëson vetëm mbylljen e shkollës, por nuk jep arsyet, është i paprecedentë, vetëm pak ditë pasi viti shkollor ka filluar, dhe nuk gjen një mbështetje të qartë ligjore.

Arsimi nuk është plaçkë private, as e Kryeministrit dhe as e Partisë Socialiste, arsimi është e ardhmja e fëmijëve tanë. Kemi arritur në pikën ku shkatërrohen trashëgimitë kulturore për t’u ndërtuar kulla sipas qejfit dhe dëshirave të qeverisë, në pikën ku mbyllen shkolla e kopshte, të cilat shërbejnë për edukimin e fëmijëve, për agjenda personale të ngushta, pa asnjëlloj shpjegimi që merr kuptim. Në Shqipëri po instalohet një precedent i rrezikshëm dhe nesër pasnesër mund të mbyllen shkolla për kapriço politike. Nuk është ky arsimi, arsimi nuk është plaçkë private. A ka qeveria shqiptare dhe Ministria e Arsimit sot një plan konkret për degët e mësuesisë, të cilat po mbyllen në të gjitha fakultetet e vendit? Kjo situatë duket edhe më problematike në rrethe, ku sot mungojnë mësuesit specialistë për lëndë të ndryshme.

Sot më shumë se kurrë, Shqipëria ka nevojë për një plan të qartë për arsimin. Nuk ishte e nevojshme që të mbushej salla me mësues për t’u zhvilluar kongresi i arsimit, të cilët ishin të detyruar të duartrokisnin dështimet e qeverisë, por ajo sallë duhej të mbushej me teknikienë dhe profesionistë, të cilët të hartonin një plan urgjent kombëtar për arsimin, pasi së shpejti do

të ngelemi pa mësues. Kush do t'i mësojë fëmijët tanë? Degradimi i arsimit në pikën ku të rinjtë nuk kanë motivimin për të studiuar më për degën më fisnike në botë, është përgjegjësi vetëm e politikës dhe për këtë do të na gjykojë historia. Ashtu siç mbyllen shkollat sipas qejfit, edhe çmimet ngrihen sipas qejfit.

Të gjitha vendet fqinje kanë miratuar plane për zbutjen e krizës së rritjes së çmimeve të produkteve të shportës dhe të rritjes së energjisë, kurse qeveria shqiptare nuk ka një plan konkret, që u shkon vërtet në ndihmë shtresave në nevojë. Duhet të kujtojmë se sot, krahasuar me një vit më parë, shqiptarët paguajnë 20% më shumë për karburantet dhe 25% më shumë për ushqimet bazë dhe trendi është në rritje. Gjithashtu, dua të ndalem edhe në një çështje tejet sensitive për shqiptarët, por edhe për mua personalisht, atë të hapjes së dosjeve. Unë vij nga një familje që gëzon statusin e të përndjekurit politik, pasi të afërm të familjes sime janë pushkatuar, gjyshi im ka bërë burg politik dhe ka vdekur me njollat e kamxhikut dhe pa thembra nga torturat në burgjet e komunizmit.

Hapja e dosjeve është domosdoshmëri në nderim të gjithë atyre, të cilët kanë humbur jetën për shkak të torturave barbare të regjimit. Është një e drejtë e çdo shqiptari që ka parë se si gjyshërve dhe prindërve u është shkatërruar jeta nga ai regjim, është një detyrim për të gjithë ata që luftuan dhe u flijuan për Shqipërinë demokratike. Ky është një vendim i vonuar në kohë, pasi duhet të kishte ndodhur më parë, por është domosdoshmëri. Skepticizmi, që e ka shoqëruar për 30 vjet këtë debat, nuk rezulton të jetë i vërtetë. Në Gjermani, Çeki apo vende të tjera të ish-Bllokut Komunist, ky proces, i cili ka filluar që në vitet '90, nuk ka prodhuar konflikte apo trazira politike dhe sociale.

Transparenca me të shkuarën është një proces i domosdoshëm për çdo shoqëri, sidomos kur e shkuara është kaq e hidhur, siç ka qenë realisht periudha e regjimit komunist në Shqipëri. Më shumë se kurrë, Shqipërisë i duhet sot kjo transparencë, në një kohë kur kasta e korruptuar politike dhe oligarkike në pushtet, në lidhje me të shkuarën komuniste, ka marrë trajtën e një kupole kriminale që kontrollon pushtetin, paranë dhe pasurinë kombëtare. Faleminderit!